



ALBANIAN LEGAL AND TERRITORIAL RESEARCH INSTITUTE

A.L.T.R.I

Asim Zeneli" Street, N°15, Tirana, Albania

E-mail : qendra.altri@gmail.com;

Website: www.altri.al

Tiranë, më 01.07.2020

Drejtuar: Znj. Drita Avdyli, Kryetare e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit

Për dijeni: Znj. Etilda Gjonaj, Ministër i Drejtësisë

Lënda: Letër e hapur për marrjen e masave për përmirësimin e mekanizmave të ofrimit të shërbimit të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim

E nderuar Znj. Avdyli,

Në vazhden e angazhimit të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit për vënien në zbatim të objektivave të Reformës në Drejtësi në lidhje me rregullimin dhe përmirësimin e shërbimit të ndërmjetësimit, po ju drejtohem i përmes kësaj letrë të hapur me qëllim parashtrimin e disa problematikave dhe rekomandimin e disa zgjidhjeve në lidhje me përmirësimin e zbatimit të institutit të ndërmjetësimit.

Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (Qendra A.L.T.R.I) është një organizatë jo-fitimprurëse e themeluar në vitin 2011, e cila synon të kontribuojë në mirëqeverisjen e vendit, forcimin e shtetit të së drejtës dhe respektimin e të drejtave të njeriut, nëpërmjet rritjes së transparencës, llogaridhënies së institucioneve, informimit dhe edukimit qytetar.

Në kuadër të mbështetjes së Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Qendra A.L.T.R.I ka zbatuar iniciativën “Përmirësimi i ofrimit të shërbimit të ndërmjetësimit nëpërmjet identifikimit të problematikave dhe propozimit të zgjidhjeve të nevojshme”, e cila ka në fokus monitorimin e efektivitetit të zbatimit të ndryshimeve në legjislacionin për ndërmjetësimin përmes Ligjit nr.26/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 10385 datë, 24.02.2011 “Për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve me Ndërmjetësim” si dhe parashikimet e Kodit të Procedurës Civile dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit. Me qëllim matjen e efektivitetit të zbatimit të institutit të ndërmjetësimit, në veçanti, në referimin e rasteve të ndërmjetësimit nga gjykatat A.L.T.R.I ka hartuar një analizë të kuadrit ligjor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim si dhe ka zhvilluar një proces monitorimi në katër rrethe gjyqësore (përkatësisht Tiranë, Shkodër, Korçë dhe Vlorë).

Në përfundim të kësaj pune kërkimore dhe monitoruese, dëshirojmë të sjellim në vëmendjen e institucionit që Ju drejtoni disa nga konstatimet kryesore të evidentuara në funksionimin e

mekanizmave ligjorë dhe institucionalë që pengojnë ushtrimin efektiv të shërbimit të ndërmjetësimin, si më poshtë vijon:

- 1- Pavarësisht ndryshimeve në kuadrin ligjor për ndërmjetësimin si alternativë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, konstatohet një mungesë e theksuar informacioni nga ana e qytetarëve për këtë institut si dhe për avantazhet që ai paraqet. Nga anketimi rezulton se 2/3 e të anketuarve nuk kanë informacion në lidhje me këtë mënyrë alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe afërsisht 90% e të anketuarve nuk do të zgjidhnin ndërmjetësimin edhe nëse i sugjerohej nga gjyqtari/prokurori. Arsyet ku bazohet kjo vendimmarrje variojnë nga:
 - mungesa e informacionit për këtë mekanizëm;
 - perceptimet e gabuara lidhur me avantazhet e tij;
 - mosorientimi i duhur nga gjyqtari/ prokurori për përzgjedhjen e këtij mekanizmi;
 - dyshimet lidhur me profesionalizmin, konfidencialitetin dhe paanësinë e ndërmjetësit;
 - kostot që lidhen me procesin e ndërmjetësimin. Në lidhje me këto të fundit, mungesa e dispozitave ligjore dhe rregullatore për reduktimin ose përjashtimin nga detyrimi i pagimit të tarifës së shërbimit të ndërmjetësit veçanërisht për grupet në nevojë, konstatohet se përbën një nga faktorët që ndikon negativisht në përzgjedhjen e ndërmjetësimin si alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
- 2- Nga të dhënat e përfutuara nga procesi i monitorimit të proceseve gjyqësore rezulton se pothuajse në 2/3 të proceseve gjyqësore të monitoruara, gjyqtarët nuk kanë përmendur mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim. Madje edhe kur gjyqtarët informojnë palët në lidhje me ndërmjetësimin, në shumicën e rasteve mjaftohen vetëm duke e përmendur këtë mundësi. Këto të dhëna dëshmojnë se detyrimi i gjykatës/prokurorit për informimin e palëve dhe veçanërisht parashtrimi i mundësive që paraqet ndërmjetësimi si alternativë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nuk zbatohen në pjesën më të madhe të proceseve gjyqësore.
- 3- Të dhënat nga procesi i intervistimit me gjyqtarë dhe prokurorë shfaqën mungesën e një praktike të konsoliduar bashkëpunimi dhe koordinimi institucional midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimin nga njëra anë, dhe gjykatës dhe prokurorisë nga ana tjetër. Sipas gjyqtarëve dhe prokurorëve, kjo mungesë koordinimi ka passjellë pamundësinë për t'u vënë në dispozicion palëve në proces të një liste me ndërmjetës të profilizuar, sidomos në rastet e ndërmjetësimin me subjekte të mitur në konflikt me ligjin.

Në përmbyllje të procesit të monitorimit janë propozuar disa rekomandime, të cilët bazohen si në kontekstin e zbatimit të legjislacionit për ndërmjetësimin në Shqipëri, ashtu edhe në praktikat më të mira bashkëkohore të ofrimit të shërbimit të ndërmjetësimin në Evropë. Disa prej tyre që lidhen drejtpërdrejte me misionin dhe funksionet e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimin mund të përmblihen si vijon:

1. Ndërmarrja e fushatave të gjera ndërgjegjësuese dhe promovuese, në koordinim me Ministrinë e Drejtësisë, me qëllim përçimin e informacionit për avantazhet procedurale, kohore, dhe financiare të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me ndërmjetësimin përmes një gjuhe të përshtatshme dhe kuptueshme për individët e të gjitha moshave, niveleve arsimore, si në zonat rurale dhe ato urbane.
2. Ndërmarrja e hapave konkrete për rritjen e përgatitjes profesionale dhe profilizimit të ndërmjetësve, me fokus të veçantë ndërmjetësit që angazhohen në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me subjekte të mitur në konflikt me ligjin;
3. Hartimi i listave me ndërmjetës të profilizuar sipas fushave, veçanërisht ndërmjetësit e profilizuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me subjekt të mitur në konflikt me ligjin;

4. Publikimi i tarifave për shërbimin e ofruar nga ndërmjetësit në faqen zyrtare në internet të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimi;
5. Zhvillimi i takimeve të përbashkëta midis Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit, Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, me qëllim bashkërendimin e veprimtarisë promovuese të këtij instituti përmes miratimit të udhëzuesëve të përbashkët që detajojnë parashikimet ligjore dhe që lehtësojnë proceduralisht shfrytëzimin e institutit të ndërmjetësimit.

Bazuar në sa më sipër, në cilësinë e organit përgjegjës për rregullimin dhe kontrollin e ushtrimit të veprimtarisë së ndërmjetësimit në Republikën e Shqipërisë, ju drejtohem i përmes kësaj letre të hapur **me një kërkesë për marrjen e masave konkrete për fuqizimin e ofrimit të shërbimit të ndërmjetësimit**. Jemi të mendimit se gjetjet dhe rekomandimet nga analiza e kuadrit ligjor dhe raporti i monitorimit, të cilët i gjeni bashkëngjitur kësaj letre, mund të informojnë më së miri procesin e rishikimit të legjislacionit dhe të kuadrit rregullator, si dhe mund të orientojnë gjetjen e zgjidhjeve konkrete nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit dhe jo vetëm.

Duke shprehur bindjen në përkushtimin tuaj të vazhdueshëm për të përmirësuar ofrimin e shërbimit të ndërmjetësimit në Shqipëri, mbetemi në dispozicion për të ofruar ekspertizën tonë në funksion të mbështetjes së iniciativave tuaja në përmbushje të këtij misioni.

Me respekt,

Eda Noçka

**Drejtoreshë Ekzekutive
Qendra A.L.T.R.I**

